

KONTRATE PER DHURIM PJESESH KAPITALI



Sot ne date 20 Prill 2005, ne Zyren e Noterise Tirane, para meje noterës Soua Mone, u paraqiten personalisht:

ARTA MICI, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane, më 16.06.1949, mbajtëse e pasaportës nr.0106602, ne cilesine e ortakes te shoqerise "ARAL"Sh.p. qe zoteron 100% te pjeseve te kapitalit.

qe ketu e me poshte do te quhet Dhuruesi

SABINA HOXHA, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane me, 20.06.1971, banuese ne Tirane, Rruga Mihal Grameno, Pallati 13, Shkalla 2, Ap.26, Tirane, mbajtese e pasaportes ne N.Z 1230318.

qe ketu e me poshte do te quhet pranuesja e Dhurimit

te cilat me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate dhurimi:

Dhuruesja dhe Pranuesja e dhurimit bien dakord si me poshte vijon:

Neni 1 - Qellimi

Dhuruesja zoteron 100% te pjeseve te kapitalit te Shoqerise "Aral"Sh.p.k dhe deshiron ti dhuroje Pranueses se Dhurimit 100% te pjeseve te kapitalit qe ajo zoteron ne Shoqeri.

Pranuesja e Dhurimit pranon dhurimin e 100 % te pjeseve te kapitalit te Shoqerise "Aral"Sh.p.k. duke marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shoqerise.

Neni 2 - Te drejtat dhe detyrimet e paleve

Dhuruesi garanton Pranuesen e Dhurimit se pjeset e kapitalit jane te transferueshme dhe te lira nga cdo barre.

Neni 3 - Mosmarreveshjet

Mosmarreveshjet qe lindin nga kjo kontrate do te zgjidhen me mirekuptim nga palet, ne rast te kundert do t'i drejtohen Gjykates kompetente shqiptare.

Neni 4 - Te ndryshme

Kjo kontrate i nenshtrohet legjislacionit shqiptar.

Kjo kontrate eshte hartuar ne 4 (tre) kopje ne gjuhen shqipe me vlere te njejte ligjore.

Kontrata e mesipeme iu lexua paleve nenshkruese prej meje noterres te cilet pasi e gjeten ate ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire e nenshkruan ate vullnetarisht perpara meje, dhe une noterja vertetoj nenshkrimin e tyre sipas ligjit.

DHURUESJA

ARTA MICI



PRANUESJA E DHURIMIT

SABINA HOXHA



*Notere
Domena no...)*

